



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes:

“CAMBRIDGE CLINICAL LABORATORIES”, SH.P.K., me numër unik identifikues 811462233, me seli e Adresën Rr."Sicilia" Kompleksi Lubjana Blloku B1/6, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga z.Ermir Cahani, në cilësinë e Drejtorit (në vazhdim referuar si "Ofruesi i Shërbimeve" dhe/ose "CCL") në njërën anë;

Dhe

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS, NRF 600595899 me adresë në rrugën "Luan Haradinaj" 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar në këtë memorandum nga z.Imer Zeqiri, Kryetar (në vazhdim referuar si "Marrësi i Shërbimit" dhe/ose "Sindikata") në anën tjetër;

Pajtohen qe:

DUKE QENË SE: Ofruesi i Shërbimit është institucion i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve analiza laboratorike;

DUKE QENË SE: Marrësi i Shërbimit, deklaron dhe garanton Ofruesin e Shërbimit se është i regjistruar dhe funksionon si Sindikatë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, është subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, dhe nënshkruesi ka tagër dhe ka të gjitha autorizimet për të hyrë në këtë marrëveshje, sipas formës dhe përmbajtjes së të njëjtës.

Si ne vijim:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje arrihet me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet palëve lidhur me ofrimin dhe marrjen e shërbimeve analiza laboratorike;
2. Ky bashkëpunim nënkupton ofrimin e ndihmës përmes zbritjeve të çmimit për marrësin e shërbimit, konkretisht për anëtarët e sindikatës së policisë së Kosovës;
3. Vendi i kryerjes së analizave laboratorike do të jetë në ambientet e CCL, me seli në adresën:
a) **lagje Kalabria**, Rr"Sicilia" Kompleksi Lubjana Blloku B1/6, Prishtinë, Republika e Kosovës, (038- 77 67 57); b) Filiali në lagje **Ulpiana**, D-7, Hyrja III Banesa Nr.4, Prishtine, Republika e Kosovës (038- 77 67 58) dhe c) Filiali në rruga e UÇK-së, Dyq. Nr. 19 **Gjakovë**, Republika e Kosovës (038- 77 67 56)
4. Analizat Laboratorike do të realizohen sipas kërkesës të paraqitur nga anëtarët e Marrësit të Shërbimeve, të cilët kanë nevojë për shërbimet laboratorike.



Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

1. Objekti i kësaj Marrëveshje është ofrimi i shërbimeve të analizave laboratorike nga CCL për të gjithë punonjësit e policisë së shtetit, familjarët e tyre dhe familjarët e rënë në detyrë apo për shkak të detyrës, sipas kushteve të rëna dakord me këtë marrëveshje dhe/apo në anekset e saj;
2. CCL merr përsipër të kryejë shërbime analiza laboratorike për gjithë anëtarët e Marrësit të shërbimit;
3. Ofruesi i Shërbimit ofron **ulje** në të gjitha shërbimet analiza laboratorike për anëtarët e lartcekur;
4. Palët pajtohen se për analizat laboratorike ose tjera që nuk kryhen nga Ofruesi i Shërbimit, por janë shërbim i jashtëm, nuk aplikohen zbritje (0%). Paketat dhe fushatat e ndryshme që i aplikon Ofruesi i Shërbimit, e përjashtojnë aplikimin e zbritjes sipas anekseve, përveç rastit kur ato janë krijuar për/ose me kërkesën e Sindikatës së Policisë për anëtarët e Sindikatës. Zbritjen sipas kësaj marrëveshje e përjashtojnë edhe zbritjet e aplikuara sipas cilësdo bazë tjetër (nuk aplikohet zbritje e dyfishtë).

Neni 3 Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë prej 1 (një) vit dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj deri më 01/04/2023.
2. Me skadimin e afatit kohor për të cilin është lidhur, Marrëveshja do të përfundojë automatikisht, përveç nëse palët 30(tridhjetë) ditë para skadimit të këtij afati, dakordohen për vazhdimin e bashkëpunimit edhe për një afat tjetër;
3. Palët, me marrëveshje të bërë me shkrim, mund ta përfundojnë këtë marrëveshje në çdo kohë, me apo pa arsye;
4. Secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme, duke i dhënë palës tjetër njoftim të shkruar 30(tridhjetë) ditë paraprakisht, pa detyrimin për të dhënë arsytet e shkëputjes;
5. Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu siç parashikon ligji. Në këtë rast palët me mirëkuptim dhe miratim të përbashkët mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve që rrjedhin nga ajo.

Neni 4 Kushtet e Përgjithshme

1. Pas përfundimit të analizave laboratorike, Ofruesi i Shërbimeve do të pajisë anëtarët e marrësit të shërbimeve me dokumentin origjinal të fletë-analizave, për çdo analize të realizuar.



Neni 5 Pagesa dhe Mënyra e Pagesës

1. Palët bien dakord se çmimi paguhet individualisht nga anëtarët e Marrësit të Shërbimeve. Kur anëtari e kryen pagesën, Ofruesi i Shërbimeve do t'i jap dëshmi përkatëse për pagesën e kryer;

Neni 6 Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

1. Anëtarët e Marrësit të Shërbimeve kanë të drejtë që të kërkojnë nga Ofruesi i Shërbimit kryerjen me përpikëri e profesionalizëm dhe në kohën e duhur të analizave laboratorike;
2. Anëtari i Marrësit të shërbimeve në paraqitje për realizimin e analizave laboratorike është i obliguar të ketë me vete kartelën identifikuese të policisë në mënyrë që të aplikohet zbritja sipas kësaj marrëveshje si në rastin kur ai/ajo vetë kryen testet ose kur i kryen për familjarët e tij/e saj;
3. Ofruesi i Shërbimit garanton për kryerjen me korrektësi, cilësi dhe mirëbesim të plotë të analizave laboratorike të kërkuara;
4. Ofruesi i Shërbimit ruan fshehtësinë e të dhënave mjekësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj dhe në këtë marrëveshje.

Neni 7 Konfidencialiteti

1. Palët në këtë marrëveshje pajtohen që të gjitha informatat të cilësohen konfidenciale nga secila palë;
2. Palët pajtohen që duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha informatat e palës tjetër të cilësuar "konfidenciale", dhe të njëjtat nuk duhet të publikohen të pala e tretë pa pëlqimin paraprak të palës tjetër, përveç kur kjo kërkohet nga një akt ligjor, nënligjor a tjetër, i nxjerrë nga një organ shtetëror, kur këtë e kërkon një organ shtetëror, ose kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm publik.

Neni 8 Komunikimet Ndërmjet Palëve

1. Palët bien dakord që të gjitha komunikimet zyrtare ndërmjet tyre do të bëhen me shkrim, nëpërmjet dërgimit të shkresës përkatëse të firmosur prej një nga personat e përcaktuar më poshtë për secilën palë dhe të vulosur prej shoqërisë, me e-mail ose përmes postës, në numrat dhe adresat e mëposhtme:

- a) **Për Ofruesin e Shërbimeve:**
Ermir Cahani - Drejtor
E-mail: ermircahani@cclkosovo.com
Tel: +383 48 835-301



b) **Për Marrësin e Shërbimeve:**

Imer Zeqiri- Drejtor

E-mail: imer.zeqiri@kosovopolicice.com

Tel: +383 (48) 714-222

Neni 9


Dispozita të fundit


1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi, se bashku me anekset e saj përbëjnë të gjithë dhe të vetmen marrëveshje ndërmjet dy palëve;
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi, si dhe ndonjë klauzolë mund të ndryshohet vetëm me miratimin e të dy palëve dhe ky miratim do të bëhet me shkrim;
3. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj marrëveshje, do të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet Palëve;
4. Kjo marrëveshje bashkëpunimi, nënshkruhet sot, me date 29/03/2022, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT NENSHKRUSE:

Ofruesi i Shërbimit:

"Cambridge Clinical Laboratories" Sh.P.K.


z. Ermir Cahani,
Drejtor



Marrësi i Shërbimit

"Sindikata e Policisë së Kosovës"


z. Imer Zeqiri
Kryetar





KONTROLI GJENDRES TIROIDE	PAKO
TSH	19 €
FT3	
FT4	
Ac.anti - TG	
Ac.anti - TPO	

KONTROLI SISTEMIT TRETES	PAKO
Hemogram	39 €
Eritrosedimenti	
CRP	
AST	
ALT	
Tbil	
Dbil	
LDH	
AMY	
Lipaza	
GGT	
Tproteine	
Albumine	
H. Pylori ne feces	
FOB - Fece gjak okult	

Monitoro DIABETIN	PAKO
ALT	26 €
AST	
Amilazemi	



Amilazemi	26 €
Insulinemi	
Lipidograme	
Hemoglobina e glukozuar (Hba1C)	

VITAMINAT DHE MINERALET	PAKO
Vitamina D	38 €
Vitamina B 12	
Ac. Folik	
Transferina	
Ferritine	
Calcemi	
Magnezemi	
Fosforemi	

TUMOR MARKERËT/Femra	PAKO
Hemogram	39 €
Eritrosediment	
CRP	
CEA	
AFP	
CA 19-9	
FOB - Fece gjak okult	
CA 125	
CA 15-3	

TUMOR MARKERËT/Meshkuj	PAKO
Hemogram	39 €
Eritrosediment	
CRP	
CEA	
AFP	
CA 19-9	
FOB - Fece gjak okult	
TPSA	
Free PSA	